VENDIM
Nr.1452, datë 5.11.2008

PËR PËRCAKTIMIN E PAGAVE TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të pikës 3 të nenit 115 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paga e kryetarit të këshillit drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare të jetë me koeficient 0.6, në raport me pagën e Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

2. Paga e anëtarëve të këshillit drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare të jetë me koeficient 0.55, në raport me pagën e Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha